



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE -SUVA REKA**



Projekt- R R E G U L L O R E

PËR

ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN

E KOMUNËS ME

FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET

URBANE

NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS

Suharekë-2012

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika (c), nenit 34, paragrafi 4, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, Nr-2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur më----- miraton:

R R E G U L L O R E N
P Ë R
ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Në bazë të kësaj Rregulloreje, rregullohet organizimi dhe bashkëpunimi në mes Komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Suharekës, zgjedhja e këshillave, kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillave, duke i siguruar qytetarët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre në shumë fusha të jetës dhe paraqitje të organizuar para Komunës dhe organeve të saj, që realizohet në pajtim me Statutin e Komunës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe akte tjera ligjore.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës, që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimarrjes.

Neni 3
Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

3.1 Për të realizuar sa ma mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe statutin e Komunës, Komuna e Suharekës do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale.

3.2 Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Suharekës është i përcaktuar në nenin 7, të Statutit të Komunës së Suharekës.

3.3 Territori dhe kufijtë e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Suharekës, janë përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave dhe mund të ndryshohen vetëm në përputhje me atë ligj.

3.4 Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjedhën këshillat, atëherë një këshill mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

Neni 4.
Pjesëmarrja në këshillin lokal

Në këshill mund të marrin pjesë përfaqësuesit e partive politike, të shoqatave eventuale dhe individit me ndikim (autoritativ), që kontribuojnë në organizimin e jetës dhe punës së fshatit, vendbanimit ose lagjes urbane të qytetit.

Neni 5.
Përfaqësimi në këshillin lokal

Sa i përketë përfaqësimit të partive politike në këshill ato do të përfaqësohen në menyrë propocionale me rezultatet e zgjedhjeve lokale për fshatin, vendbanimin ose lagjen urbane.

Neni 6
Formimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale

- 6.1 Kuvendi i Komunës emëron-formon një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
- 6.2 Komisioni duhet të përfshijë anëtarë të spektrit politik, etnik dhe gjinor të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës si dhe profesionistë ligjorë.
- 6.3 Komisioni emërohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.
- 6.4 Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 14, ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
 - a). shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen këshillave;
 - b). mediave lokale të shkruara dhe elektronike;
 - c). web – faqes zyrtare të komunës.
- 6.5 Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:
 - a). rendin e ditës;
 - b). datën;
 - c). kohën;
 - d). vendin e mbajtjes së tubimit.

Neni 7
Procesverbali nga tubimi zgjedhor

- 7.1 Procesverbali i tubimit të qytetarëve, duhet të përmbajë: numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e këshillit lokal, procedurat e votimit dhe çështje tjera të nevojshme që duhet të shënohen në procesverbal.
- 7.2 Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 6 të kësaj Rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 8.

Përbërja e këshillit

- 8.1 Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, do të ketë Kryetarin e këshillit, Nënkyetarin e këshillit, sekretarin dhe anëtarët e këshillit, të cilët zgjedhen konform procedurave të paraparë në nenin 9, të kësaj rregullore.
- 8.2 Sa i përket kandidatëve të pavarur në këshill (njërzëve me autoritet) të paraparë edhe në nenin 4, të kësaj rregullore ata mund të jenë anëtar të këshillit, por duhet ti nënshtrohen procedurave të paraparë në neni 9, të kësaj rregullore për t'u zgjedhur.

Neni 9

Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

- 9.1 Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane do të kenë nga 5-11 anëtarë dhe do të reflektoj me përfaqësimin gjinor dhe etnik..
- 9.2 Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill, përcaktohet në bazë numrit të banorëve të atij fshati, vendbanimi apo lagje urbane.
- 9.3 Fshati, vendbanimi dhe lagja urbane që numëron deri në 2000 banorë këshilli duhet të ketë 5 anëtarë.
- 9.4 Fshati, vendbanimi apo lagja urbane që numëron prej 2000 banorë deri në 3000 banorë këshilli duhet të ketë 7 anëtarë.
- 9.5 Fshati, vendbanimi apo lagjij urbane që numëron mbi 3000 banorë këshilli duhet të ketë 9 anëtarë.
- 9.6 Në rast se këshilli zgjidhet për më shumë fshatra, vendbanime apo lagje urbane, atëherë përbërja e këshillit duhet të reflektojë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane, përfshirë këtu edhe përfaqësimin gjinor dhe etnik.
- 9.7 Në rast se në fshatra, vendbanime apo lagje urbane jetojnë anëtarë të pakicave, ata mund të marrin pjesë në këshill por me kusht që numri i grupeve etnike të përbën të paktën në 5% të popullatës së atij fshati, vendbanimi apo lagje urbane.
- 9.8 Këshilli i fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve zgjidhet në tubimet e qytetarëve, përmes votimit të fshehtë apo të hapur.
- 9.9 Tubimin publik e hap qytetari më i moshuar, i cili merr pjesë në tubim dhe kryeson me tubimin deri në zgjedhjen e këshillit.
- 9.10 Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane zgjedhën me mandat 4-vjeçar dhe nga radhët e anëtarëve të tij zgjidhet kryetari, me mandat 4-vjeçar, deri të zgjedhja e kryetarit të këshillit, me këshill udhëheq anëtar më i moshuar i atij këshilli.
- 9.11 Kryetar i këshillit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar të këshillit nuk ka fituar numrin e duhur të votave, atëherë organizohet rrethi i dytë i votimit për dy kandidatë, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.
- 9.12 E njëjta procedurë e votimit aplikohet për zgjedhjen e nënkryetarit dhe sekretarit të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, vlen.
- 9.13 Kryetari i këshillit thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Po ashtu, ai i nënshkruan aktet e miratuara nga ana e këshillit dhe është i obliguar t'i dorëzojë te Kryetari i Komunës në afat prej 14 ditësh nga dita e miratimit të tyre, me qëllim të publikimit të tyre në gazetën zyrtare ose ueb-faqen e Komunës.

- 9.14 Këshilli, anëtarët, kryetari, nënkryetari dhe sekretari, mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se nuk kanë kryer obligimet që dalin nga kjo Rregullore dhe legjislacioni i zbatueshëm.
- 9.15 Shkarkimi i këshillit, i kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit bëhet sipas procedurës së njëjtë për zgjedhjen.

Neni 10

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës me qëllim të promovimit të transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në vendim marrje.

Neni 11

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

- 8.1** Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
- a.** Hartojnë dhe miratojnë rregulloren e punës së këshillit;
 - b.** Organizojnë, përcjellin dhe planifikojnë zhvillimet e lokalitetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, komitetet, Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë e Administratës së Komunës;
 - c.** Emërojnë komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e fshatit, vendbanimit dhe lagjes;
 - d.** Evidencojnë dhe paraqesin prioritetet e lokalitetit para organeve të Komunës;
 - e.** Hartojnë planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat e jetës;
 - f.** Ndërmarrin iniciativa për ruajtjen e objekteve në pronësi të Komunës dhe në pronësi shtetërore, dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës;
 - g.** Bëjnë llogarinë 6-mujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe i bën ato transparente për qytetarët e lokalitetit, në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës dhe të kësaj Rregulloreje;
 - h.** Sigurojnë të dhënat elementare për secilën familje të lokalitetit përkatës, përcjellin gjendjen ekonomike të tyre dhe japin rekomandime e propozime në lidhje me këto;
 - i.** Caktojnë persona përgjegjës, të cilët ngarkohen me faturat për përcjelljen e gjendjes financiare të lokalitetit, sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të posaçëm të këshillit të lokalitetit;
 - j.** Kujdesen për organizimin e aksioneve vullnetare në interes të lokalitetit;
 - k.** Kujdesen për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
 - l.** Kujdesen për sigurimin e hapësirave dhe varrezave;
 - m.** Kujdesen për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimet dhe ofrimin e shërbimeve publike efikase në lokalitet etj.;
 - n.** Kujdesen lidhur me ofrimin e mbrojtjes parësore shëndetësore të qytetarëve të lokalitetit;
 - o.** Kujdesen për mbrojtjen e mjedisit të lokalitetit;
 - p.** Kujdesen për zhvillimin e turizmit;

- q. Nxjerrin vendime dhe rekomandime në interes të qytetarëve të lokaliteteve në komunë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm;
- r. Në pajtim me nenin 69, të ligjit për vetëqeverisje lokal dhe në pajtim me nenin 23, të Statutit të Komunës së Suharekës, kanë të drejtë që me vetiniciativë, përmes formës së petitionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidhen çështje të rëndësishme për qytetin, fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane .
- s. Kryejnë edhe detyra të tjera, të cilat mund të jenë të bartura nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

8.2 Këshilli lokal mundet t'i parashtrojë organeve të pushtetit lokal, Kuvendit të Komunës, (legjislativit) dhe Komunës (ekzekutivit), pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e cekura më lartë brenda afatit prej 30 ditsh, duhet të ju kthejnë përgjigje me shkrim këshillit lokal.

Neni 12

Këshilli ka për obligim parapengimin apo parandalimin e të gjitha ngatrrsave-konflikteve eventuale si dhe eliminimin eventual të tyre (ngatrrsave-konflikteve), përmesë konsultimeve, bisedimeve, marrëveshjeve miqësore, duke angazhuar edhe njerëz që kanë ndikim në këtë çështje.

Neni 13

13.1 Në bazë të nevojave dhe kërkesës së qytetarëve, apo me iniciativën e Këshillit, mund të përcaktohet grumbullimi i vetë kontributit të qytetarëve, për përmirësimin e jetës së qytetarëve në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

13.2 Këshilli merr vendimin për formimin e komisionit të veçantë të cilit gjatë përcaktimit të vetë kontributit t'i studiojnë veç e veç mundësit financiare-materiale të çdo familje, për të marruar pjesë në vetë kontribut në mënyrë që mos të cenohet e drejta e tyre elementare dhe përkeqësimi i gjendjes financiare dhe materiale.

Neni 14

Përgjegjësitë e bartura nga Komuna në këshill

14.1 Me kërkesën e Këshillit dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim, mund t'i delegoj disa aktivitete për t'i ushtruar këshillat e fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, konform dispozitave ligjore të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 8, të Statutit të Komunës së Suharekës.

14.2 Të gjitha aktivitetet bëhen me marrëveshje me shkrim dhe nuk mund të jenë me kohë zgjatje më të gjatë se mandati i Kuvendit të Komunës dhe gjatë secilit vit fiskal të gjitha marrëveshjet për mbikëqyrje të përbashkët të aktiviteteve të deleguar duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Statutin e Komunës së Suharekës.

14.3 Komuna ofron burime-informacione të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

14.4 Në raset se Kuvendi i Komunës apo Kryetari i Komunës, konstaton ose vëren se aktivitete e deleguar nuk ushtrohen konform dispozitave të kësaj Rregullore, Statutit të Komunës apo ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Komunës mund t'i tërheq delegimin në çdo kohë.

Neni 15

Bashkëpunimi i organeve të Administratës së Komunës me këshillat e lokaliteteve

15.1 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Suharekës, me pëlqimin e tyre, mund të organizohen dhe bashkëpunojnë mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga Komuna.

15.2 Vendimin për bashkëpunimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e miraton Kuvendi i Komunës, në bazë të kërkesës së tyre.

Neni 16

Mospërbushja e përgjegjësi

16.1 Për të gjitha punët e bartura në këshill nga Kuvendi i Komunës, këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse, mban obligime dhe përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual.

16.2 Përgjegjësia para qytetarëve dhe organeve përkatëse, mund të jetë individuale apo kolektive.

Neni 17

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës mbizotërojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.

Neni 18

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të miratimit të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 8, (tetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare 28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 20.

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për punën dhe organizimin e kryesive të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-214, të datës 31.08.2001.

KUVENDI I KOMUNËS– SUHAREKË

01-Nr-_____

Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Vesel Maliqaj